Lezhë, më 11.07.2023

# PROCES VERBAL

I mbajtur sot, në dt. 11.07.2023, në orën 11:00, në sallën e Qendrës Kulturore të Fëmijëve, mbi konsultimin publik në lidhje me disa ndryshime në Rregulloren e Funksionimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Fjalën e hapjes e mbajti kryetari i këshillit, z. Ndue Luli, i cili falenderoi pjesëmarrësit për pjesëmarrjen. Ai theksoi se rregullorja e këshillit ka nevojë për një ndërhyrje të përgjithshme dhe i dha fjalën z. Agostin Marku, ZV/Kryetar, për të dhënë detaje më të hollësishme.

Agostin Marku: Edhe unë gjej rastin t'ju falenderoj për sensibilizimin për të dhënë kontribut për aq sa është e mundur për probleme bazike për mënyrën e funksionimit të këshillit. Realisht duket sikur janë riformulime që nuk çojnë shumë peshë, por ka një ndryshim rrënjësor tani këshilli. Mendojmë që ky ndryshim do të jetë për mirë dhe do ndikojë në rritjen e cilësisë së vendimmarrjes në këshill, që i paraprin dhe strategjive të zhvillimit që janë për Bashkinë e Lezhës. Është pozitive që këto ndryshime me iniciativë të kryesisë së këshillit kanë patur miratimin e plotë edhe të kryetarit të Bashkisë. Gjej rastin të falenderoj edhe përfaqësuesin e projektit "Bashki të Forta" z. Hekuran Koka, që

na ke dhënë asistencën edhe për këto ndryshime. Ishte i alarmuar në fillim për daljen jashtë asaj kornize për ato kemi sjellë, por na duket të përshtatemi sipas kushteve konkrete. Këto ndryshime që ne kemi sjellë kanë të bëjnë me formatimin e grupeve politike, me mënyrën e funksionimit të komisioneve, që janë po aq të rëndësishme, për të rritur cilësinë e vendimmarrjes. Në këshill deklaratat janë në këndvështrimin politik, ndërsa në komisione diskutimi është në kuadrin teknik. Ne do ndryshojmë tërësisht edhe rregulloren për strukturat komunitare, së bashku me Hekuranin, që do e shtrojmë për konsultim. A do kjo rregullore ndryshime të thella? Po, do. Do na lënë kohës. Më pas do merren komisionet, sepse ashtu mendimi do jetë edhe më i kualifikuar.

z. Ndue Luli: Faleminderit z. Marku.

Atëherë po e nisim me pyetjet dhe diskutimet që ju mund të keni.

Vasilike Losha (SIFD): Në një nga pikat thuhet që sekretari zëvendësohet nga drejtuesi i mbledhjes. A krijon kjo një farë keqkuptimi mes Kryetarit dhe drejtuesi i mbledhjes gjatë kohës së mbledhjes së këshillit Bashkiak,

Hekuran Koka: Është teknike kjo dhe nuk

na përket neve si qytetarë.
Agostin Marku: ke të drejtë se po ta shohësh kështu, thua i iku një kompetencë Sekretarit. Kjo gjë është një lapsus që është bërë në rregullore, e cila është miratuar, për sa i përket mbledhjes konstituese, pra mbledhjes së parë të këshillit, që realisht është e përcaktuar edhe në ligj, e drejton këshilltari më i vjetër. Ai quhet drejtuesi i mbledhjes, deri sa të zgjidhet kryetari i këshillit.
Hekuran Koka: Ato që na interesojnë neve sot si qytetarë janë komisionet që nga 8 bëhen 10 dhe grupet politike. Detajet e tjera janë korrigjime teknike.
Ndërsa për "drejtues i mbledhjes", ne jemi munduar ta përdorim shqip në rregullore sepse drejtues i mbledhjes mund të jetë Kryetari i këshillit, por mund të jetë edhe zv/kryetari i këshillit. dhe për këtë arsye është përpjekur të shmanget termi "kryetar."
Fabjola Ndoj (H.A.N.A) Komisionet janë bërë nga nëntë në dhjetë. A do ketë kritere për përfshirjen e këshilltarëve në komisione.
Ndue Luli: Në mbledhjen që do kemi nesër ne kemi ngjiftuar këshilltarët por dhe individë të veçantë sepse faktikisht drejtues grupesh politike akoma nuk kemi. Kemi bërë ca

takime me disa prej tyre që kryesojnë listat e partive dhe kemi diskutuar rreth këtyre problemeve dhe u është thënë që nesër, secili grup politik të vijë i përgatitur për ndarjen e këshilltarëve nëpër komisione

Fatjola Ndoj: A mund të ndodhë që një grup politik të ketë shumë më shumë anëtarë në një komision se sa një grup tjetër?

Ndue Luli: Do e shikojmë shpërndarjen.

Alfride Marku (PD): A ka patur dëgjesë tjetër publike, përveç të sotmes, rreth këtyre ndryshimeve në rregulloren e këshillit dhe cila është arsyeja që e konsideroni emergjente.

Ndue Luli: Jo

Alfride Marku: Sepse me fitur respektin për pjesëmarrësit, dëgjesa publike përfaqëson shumë më shumë. Vajzat përfaqësojnë disa organizata të shoqërisë civile, Erini është pjesë e një subjekti politik, unë po ashtu, Gjergji Fijuri në funksion e gazetarisë, Hekurani me projektin "Bashki të forte", pra të fitojmë ne bashkë me ju nuk përfaqësojmë interesin publik. Edhe n.p.s ka pasur dëgjesa publike përpara, kanë pasur me punonjës administrate.

Ndue Luli: Për mandatin që shkoi janë bërë dëgjesa publike për buxhetin dhe

paketën fiskale

Alfride Marku: Unë i kam parë dëgjesat publike. Në çdo njësi administrative janë dominuar nga punonjës administrate e nga struktura politike, pra nuk ka arritur këshilli, me fitimet atë mangësinë e madhe që ka pasur një drejtim politik, që të marrë mendimet e komunitetit. A do e ndryshojmë ne këtë?

Ndue Luli: Nuk është bërë dëgjesë publike pas konstituimit në lidhje me këtë problem. Ne ngapak duam të ndryshojmë diçka, e nisëm me diçka të vogël, në mënyrë që të shkojmë te të mëdhatë. Është bërë një takim këtu për konsultim publik në lidhje me Planin e Përgjithshëm Vendor, para ca kohësh dhe më besoni ka pasur një pjesëmarrje krejt të vakët. Njerëzit janë shumë indiferentë në lidhje me këto probleme.

Gjergj Fifuri: Ose mosbesues për shkak të historikut

Ndue Luli: Ama indiferentizmi është në pen te shumica prej nesh

Sot e pjej një nisje të mirë edhe pse diçka e vogël.

Ne si këshill, së bashku, të jemi ne ata që të jemi shpërndarës të njoftimeve, të sensibilizimit të komunitetit për të pasur pjesëmarrje, për të dhënë mendime.

Alfride Marku: Pse grupet politike të ndryshohen nga tre në pesë këshilltarë, ku si rregull, duke filluar nga parlamenti te këshillat më të mëdhenj të bashkive Shkodër, Tiranë, cila është analiza që na na çon nga treshi te pesë?
Po të bëjmë një analizë të këshillit, janë 15 këshilltarë që janë 2 ose 1 nëpër subjekte politike, pra është më shumë se sa 1/3 e këshillit. 3 janë parti që e tejkalojnë.
Nëse marrim orientimin politik, 80% e këshilltarëve janë pozitë, pra në me këtë skemë e grupimeve politike, jo më pak se 5, praktikisht i kemi mohuar të drejtën e fjalës 15 këshilltarëve.
Ndue Luli: Jo, jo. Në grupimet politike nuk futen me siglën e partisë.
Alfride Marku: Profesor, realiteti është i tillë. Nuk është e lehtë të krijosh grupime politike me 5 këshilltarë me këtë mënyrë se si është konfiguruar këshilli.
Cila është arsyeja që juve ju ka bindur për të qenë me 5?
Ndue Luli: Ku qëndron e mira që të jetë 3?
Ta bëjmë bashkëbisedim.
Alfride Marku: I jep mundësinë të gjithë këshilltarëve për të qenë në grupime politike dhe automatikisht të përfaqësohen në komisione, të kenë akses në veprimtarinë e bashkisë, të

gjënë përfaqësues të interesit qytetar.
Agostin Marku: Po me 5 nuk i jep?
E pengon?
Alfrida Marku: Është më e vështirë.
Agostin Marku: Ne nuk duhet të paragjykojmë asgjë. Çdo strukturë me 3 është e destinuar të dështojë. Me 3, nga ana organizative, sidomos kur janë struktura të zgjedhura, të gjitha rastet duhet 1 kryetar, 1 zv/kryetar, 1 Sekretar.
3 vetë, 3 vetë zgjidhen. Ku është anëtarësia?
Me 3, përfaqësimin në komisione nuk e ke të duhurin për të arritur maksimumin e asaj që kërkon, edhe politikisht, edhe në raport me komunitetin. Me 5 përfaqësimi është më dinjitoz.
Unë për vete gjej 1, ti gjej 2. Ti e ke probabilitetin më të lartë të krijosh grup.
Nga spektri politik janë 15 të djathtë dhe 19 të majtë në këshill. Ndoshta bëhen si atë ditë, 39 të majtë.
Alfrida Marku: Nuk ishin të majtë.
Ishin 39 për Ndue Lulin.
Agostin Marku: Në nenin 28, pika 4 është bërë riformulimi "Grup i përzier i këshilltarëve" është bërë shumë mirë.
5 është minimumi. Grupi politik mund të bëhet dhe me 15.
Alfrida Marku: Si realizohet përfaqësimi në

komisione i këshilltarëve që nuk janë pjesë e një grupi politik?
Agostin Marku: E kemi shkruar më poshtë. Çdo këshilltar ka të drejtë të marrë pjesë deri në 2 komisione. Shikohet dhe ana profesionale, për aq sa është e mundur. Kemi futur edhe përfaqësimin mbi bazë gjinore.
Alfrida Marku: I kemi orientuar grupet politike në 3 pjesë.
Ndue Luli: E ke kuptuar gabim.
Ato që janë 1, 2, 4 kombinohen dhe kujdesjnë grupet politike.
Agostin Marku: Mund të ketë këshilltar që nuk dëshiron të jetë pjesë e komisioneve.
Grupimi me 5, thyesat i konsolidon.
A e kushtëzon vendimmarrjen?
Alfrida Marku: Kushtëzon opozitën. Ka minutazh.
Agostin Marku: Çdo këshilltar ka minutazh.
Gjergji Fijani: Sa herë që të propozoni ndryshime, mirë është që ta shmangni "ishte" dhe "do bëhet". Sepse këtu e kemi vetëm "do bëhet".
Meqë po flitet për komisionet, a është përcaktuar në rregullore se si do ndahen komisionet dhe përbërja e tyre politike?
Dëgjesat publike nuk kanë funksionuar asnjëherë.
Vetë Këshilli a ka një planifikim se si do

funksionojnë këto dëgjesa?

Hekuran Koka: Vjet kemi bërë një eksperiment me Floridën dhe Ernestin (ish kryetari i këshillit) në bazë të rregullores, me afatet, kemi vënë njoftimet në Facebook dhe web. Kemi ardhur në orar dhe vetëm 1 qytetar ka ardhur. Unë sot jam kureshtar për atë vetë se jemi këtu. Nuk i kushtonte gjë z. Luli që t'i thoshte kryetarit të Bashkisë te website sallën me administratën e bashkisë.

Unë e kam asistuar këshillin për të bërë këto ndryshime dhe gjykoj që këto ndryshime favorizojnë opozitën. Krijimi i grupeve politike me 5 këshilltarë konsolidon grupet që udhëheqin këshillin. Grupet, po të lihen me 3 është njësoj si me 1.

Agostin Marku: Rregullorja ka pasë që një këshilltar ka të drejtë të marrë pjesë deri në 4 komisione. Me atë përbërje favorizohej maxhoranca. Ne e kemi kushtëzuar në 2 dhe kështu nuk mbetet asnjë anëtar këshilli pa marrë pjesë në komisione. Mungesa e gjithsecilit nuk siguron maxhorancën për funksionimin e komisionit. Tjetër, në nenin 34, pas pikës 8 shtohet pika 9 ku thuhet që për çdo çështje të paketës fiskale dhe të buxhetit të mblidhen të gjitha komisionet, kur përpara është mbledhur vetëm Komisioni i Ekonomisë. Kjo është në kuadrin e transparencës.

Gjergj Figuri: A keni parashikuar që pasi t'i përfundoni këto dëgjesë publike, të dilet me një relacion se si vijohet më pas.
Ndue Luli: Është e shkruar, aty ku është kryetari i pozitës, zv/kryetari është i opozitës dhe anasjelltas, por po të shikosh hollë-hollë dhe zv/kryetarit me 1/3 duhet të jenë.
Është e vërtetë që dëgjesat nuk kanë funksionuar ashtu si duhet, por në bazë të mendimeve këtu do ketë edhe reflektime.
Konkretisht, deri në 30 përqind duhet të ishte miratuar faza e parë e PBA-së 2024-2026 por për shkak të situatës zgjedhore nuk janë zhvilluar konsultime, por do kemi 2 fazat e tjera, këtu do jemi, për konsultim publik.
Elona Capo (Terres des Hommes) - Te ngritja e komisioneve a do i kushtoni rëndësi barazisë gjinore?
Ndue Luli: Patjetër që po.
Urojmë që mos të kesh zvogëlim të numrit të grave dhe vajzave në këshill.
Vasilika Laske: A parashikoni ju ndonjë rregull që të kufizoni ndryshimin.
Ndue Luli: Është çështje që e rregullon KQZ-ja.
Erin Ndreca (PS) - Është dhe diçka personale.
Alfrida Marku: 7 anëtarë komisioni, i bie që 1/3 të jenë gra.

Agostin Marku: Me sa parashikohet numri do bëjë shumë.
Por, po të shihni te neni 33, pika 6, është riformuluar emri i komisionit duke shtuar dhe Barazinë Gjinore.
Elona Copa: Të paktën, sigurohemi që gratë që ngelen të jenë nëpër komisione.
Agostin Marku: Do bien raportet se çdo pjesë do jetë pjesëtare.
Alfride Marku: Profesor, me gjithë respektin dhe besimin që të kemi dhënë përtej politikës, si mësues, si qytetar model, do të lutesha, t'i jepet rëndësi e madhe dëgjesave publike, që mos të kenë efektivitet dhe t'u jepet mundësi gjithë këshilltarëve që të kenë akses në veprimtarinë e institucionit të bashkisë.
Erin Ndreca: Jam shumë dakord me pjesën e dëgjesës publike por jemi përballë një problemi për faktin që ka indiferencë dhe mosbesim që kanë njerëzit në raport me ta. Këshilli është një organ goxha i rëndësishëm për vendimmarrjen. Është fat që në këshill kemi njerëz si profesori, Agostini por dhe Alfriden, që kanë arsimim, që të kenë ca ide për të dhënë për zhvillimin e qytetit. Por është fat që kemi një bashki që punon. Të përpiqemi që të rregullojmë

përpara për të dhënë më të mirën tonë me ide, me opozitë përsëri, por me opozitë konstruktive. Mendoj që grupimi me 5 këshilltarë i jep më shumë rëndësi një grupimi, i jep më forcë. Nuk e shoh si dobësi. Të shohim interesat e qytetarëve, jo ato personale.

Këto janë procedura, por të e fundit e dimë që është këshilli që vendos me votë.

Ndue Luli: Ju faleminderoj vërtet për pjesëmarrjen dhe mendimet dhe mbetet për t'u parë angazhimi i këshilltarëve në komisione por dhe në procesin e zgjedhjeve të kryetarëve të fshatrave që do jetë shumë shpejt.

Për këshillin e Bashkisë Lezhë
SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ
[signature]